| **Nr.** | **Informacioni që bëhet publik pa kërkesë** | **Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni** | **Afati kohor për publikim** | **Organi miratues** | **Organi përgjegjës për publikimin** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4.Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve.<br>Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve | për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | | | |
| 7 | **Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim** në lidhje me konsultimin publik.<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1.Subjektet ku mund të bëhet ankesa (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli i NJVV, Titullari i NJVV)<br>2.Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës,<br>3.Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun<br>4.Struktura përgjegjëse në nivel NJVV që regjistron dhe shqyrton ankesën | a) Në faqen zyrtare të internetit-menuja........ (me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Menjëherë | Këshilli i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| 8 | **Raporti vjetor për transparencën** në procesin e vendimmarrjes. Përfshin bërjen publike të:<br>1.Numrit të akteve të miratuara nga organet e i NJVV me konsultim publik gjatë një viti.<br>2.Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;<br>3.Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuara dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes.<br>4.Numrin e takimeve publike të organizuara | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........ (me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit | Këshilli i NJVV<br><br>Titullari i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik. |
| 9 | **Iniciativa qytetare.** Përfshin bërjen publike të:<br>1.Mënyrës dhe formës së paraqitjes së iniciativës qytetare<br>2.Procedurave të shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare<br>3.Adresës postare/ elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare.<br>Mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mos miratimin e iniciativës qytetare | a) Në faqen zyrtare të internetit-menuja........ (me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit | Këshilli i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |

**Fusha 7 - Informacion tjetër**

| Nr. | Informacioni që bëhet publik pa kërkesë | Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni | Afati kohor për publikim | Organi miratues | Organi përgjegjës për publikimin |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **NJVV në proceset e integrimit evropian.**<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1.Të dhënave për projektet, nismat dhe veprimtarisë e NJVV në kuadrin e integrimit në BE | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........ (me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| 2 | **Bashkia dhe shoqëria civile.** Përfshin bërjen publike të:<br>1.Në tërësi të dhëna për grupet e interesit<br>2.Të dhëna për OJF, përfaqësuesit e medias, biznesit<br>3.Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme<br>4.Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........ (me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| 3 | **Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të transparencës.**<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1.Raporte, studime dhe vlerësime mbi PT<br>2.Sisteme/metodologji matje të PT | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........ (me link)<br><br>b)Vendet e caktuara | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | | | |
| 4 | **Strukturat komunitare** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Dhënave për strukturat komunitare në fshat<br>2. Dhënave për strukturat komunitare në qytet<br>3. Detyrat, kompetencat dhe kompetencat e strukturave komunitare<br>4. Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare | a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja........ (me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

| Fusha 8 – Këshilli Bashkiak | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Informacioni që bëhet publik pa kërkesë** | **Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni** | **Afati kohor për publikim** | **Organi miratues** | **Organi përgjegjës për publikimin** |
| 1. | **Informacion rreth këshilltarëve:** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Lista e këshilltarëve.<br>2. Biografi e shkurtër e këshilltarëve.<br>3. Kontakte të këshilltarëve nr. telefoni/ email-i zyrtar. | a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja........ (me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 2. | **Informacion rreth komisioneve:** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Përshkrimi dhe përbërja e komisioneve.<br>2. Njoftim për takimet e komisioneve.<br>3. Agjenda dhe dokumentet për diskutim.<br>4. Raportet e mbledhjeve të komisioneve për projekt-aktet e diskutuara. | a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja........ (me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 3. | **Kuadri rregullator i këshillit NJVV:** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Ligje dhe udhëzime për qeverisjen vendore me fokus këshillat.<br>2. Rregullore e funksionimit të këshillit të NJVV-së.<br>3. Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të këshilltarëve NJVV-e.<br>4. Rregullore për marrëdhënien e këshillit NJVV me publikun dhe median.<br>5. Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve, dhe iniciativave qytetare. | a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja........ (me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 4. | **Mbledhjet e këshillit:** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Njoftimi paraprak për mbledhjet (data, ora, vendi, agjenda).<br>2. Dokumente përgatitore për mbledhjet.<br>3. Procesverbalet dhe vendimet pas mbledhjeve.<br>4. Mbledhjet live të Këshillit. | a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja........ (me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 5. | **Konsultimet publike:** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Të dhënat e Sekretarit të Këshillit NJVV (Emër Mbiemër, telefon, adresë email).<br>2. Plani vjetor i konsultimeve të Këshillit.<br>3. Regjistri i projekt-akteve për konsultim.<br>4. Njoftimi i konsultimeve në faqen e internetit të Këshillit.<br>5. Përmbledhje e pas-konsultimit në raport zyrtar.<br>6. Raporti vjetor i transparencës së konsultime publike/dëgjesave publike. | a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja........ (me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 6. | **Vendimet e Këshillit të NJVV:**<br>1. Projekt-Vendimet e Këshillit NJVV<br>2. Vendimet e Këshillit të NJVV (relacionet dhe çdo dokument tjetër bashkëlidhur vendimit). | a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja........ (me link)<br>b) Vendet e caktuara | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | | | |
| 7 | **Kërkesat dhe përgjigjet drejtuar Këshillit NJVV:**<br>1. Procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe ankesës pranë Këshillit NJVV.<br>2. Formular për dorëzimin e kërkesave Këshillit NJVV.<br>3. Formular për dorëzimin e ankesave Këshillit NJVV.<br>4. Regjistër i kërkesave dhe përgjigjeve i Këshillit NJVV (përfshirë përgjigjen e dhënë, të anonimizuar) | a) Në faqen zyrtare të internetit-menuja…….. (me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 8 | **Veprimtaria e Këshillit, Komunikimi me Publikun dhe aspekte të tjera:**<br>1. Raporti vjetor i punës së këshillit.<br>2. Buxheti vjetor i këshillit.<br>3. Raporti vjetor i konsoliduar për zbatimin e buxhetit.<br>4. Kalendari vjetor për trajnimet.<br>5. Vlerësim i performancës së këshilltarëve nga aktorë të brendshëm.<br>6. Vlerësim i performancës së këshilltarëve nga OSHC-të.<br>7. Regjistër i peticioneve dhe iniciativave qytetare.<br>8. Deklaratë publike e Titullarit/es së Këshillit për përmirësimin e transparencës.<br>9. Regjistër i OSHC-ve dhe ekspertëve lokalë.<br>10. Statistika | a) Në faqen zyrtare të internetit-menuja…….. (me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA LIBOHOVË**
**KODINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

**Nr.946 Prot** **Libohovë, më 21.05.2026**

## PROJEKT-VENDIM

**NR _____, DATË _______________**

### PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS NË BASHKINË LIBOHOVË

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, neni 54, ligjit nr,119/2014 "Për të drejtën e informimit", I ndryshuar, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore", pasi shqyrtoj matrialin e paraqitur nga kryetari I bashkisë:

**VENDOSI :**

I. Të miratojë Programin e Transparencës për Bashkinë Libohovë, pjesë përbërse bashkëlidhur këtij projekt vendimi.

II. Të ngarkojë të gjitha strukturat administrative të Bashkisë Libohovë për zbatimin e Programit të Transparencës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. Programi I transparencës të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Libohovë dhe të përditësohet në mënyrë periodike, sipas kërkesave ligjore.

IV. Të ngarkohet Kordinatori për të Drejtën e Informimit për ndikien, monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e këtij programi.

V.Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

| Kordinatori | KRYETARI | Juristi |
|---|---|---|
| Daniela Hila | Leonard Hide | Kristaq Ciko |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KODINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. Prot Libohovë, më ____.____.2026

RELACIN

PËR PROJEKT VENDIMIN NR. DATË /05/2026, PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TË TRANSPARENCËS NË BASHKINË LIBOHOVË.

Ky relacion ka për qëllim të paraqesë arsyetimin dhe bazën ligjore për miratimin e programit të transparencës në bashkinë Libohovë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, si dhe të theksojë rëndësinë që ky program ka për garantimin e transparencës, llogarridhënjes dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet administratës vendore dhe qytetarëve.

Baza Ligjore:
-Kushtetuta e Shqipërisë, që garanton të drejtën për informacion;
-Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" I ndryshuar;
-Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar;
-Urdhri nr. 281, datë 30.12.2025 I Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtien e të dhënave personale "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë Vetëqeverisjes Vendore";
-Aktet ligjore dhe udhëzimet përkatëse në fushën e transparencës dhe qeverisjes më të mirë.

Argumentimi I projekt vendimit:

Rëndësia e programit tëtransparencës, zbatimi I programit të transparencë përbën një instrument thelbësor për garantimin e qeverisjes së hapur dhe për forcimin e besimit të qytetarve ndaj institucionit të Bashkisë Libohovë.

Programi synon të:

-Sigurojë publikimin sistematik dhe në kohë të informacionit publik;
-të rrisë aksesin e qytetarve në vendimarrje;
-të përmirësojë standartet e llogardhënies institucionale;
-të forcojë integritetin dhe transparencën në administratën vendore;
-të kontribojë në përmbushjen e standarteve të integrimit evropian në nivel vendor.

Vështrimi I situatës aktuale:

Bashkia Libohovë në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të shë shërbimeve dhe rritjes së transparencës instititucionale ka ndërmarrë hapa për publikimin e informacionit në faqen zyrtare për kominikimin me qytetarët.

Megjithatë evidentohen nevoja për :

-Standartizimin e publikimit të informacionit sipas një strukture të unifikuar;
-Përditësimin periodiktë të dhënave në përputhje me kërkesat ligjore;
-forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit;
-rritjen e ndërveprimit me qytetarët dhe grupet e interesit.

Vizioni dhe objektivat kryesore.
Vizioni

Një administratë vendore transparente e përgjegjshme dhe e hapur ndaj qytetarve, që garanton akses të plotë në informacion dhe pjemarrje aktive në vendimarrje.

Objektivat kryesorë:

-Transparencë institucionale:publikim i plotë i struktuës fuksionale dhe veprimtarisë së bashkisë;
-llogaridhënia financiare:publikim i buxhetit, shpenzimeve dhe proçeseve të prokurimit;
-aksesi në informacion: lehtësim i proçedurave për kërkesat për informacion;
-përmirësimi i shërbimeve: transparencë mbi shërbimet dhe standartet e tyre;
-pjesmarrja e qytetarve: rritja e konsultimeve publike dhe përfshirjes së komunitetit.

Përmbajtja e Programit të Transparencës
Programi i transparencë i Bashkisë Libohovë strukturohet në disa fusha kryesore:-Organizimi dhe fuksionimi i bashkisë;

-Transparencë ekonomiko-financiare;
-proçedurat për të drejtën e informimit;
-shërbimet publike dhe administrative;
-legjislacioni dhe aktet vendore;
-pjesmarrja e qytetarve në vendimarrje;
-informacion mbi projektet dhe bashkëpunimet;
-veprimtaria e këshillit bashkiak.

Ky program garanton publikimin e informacionit pa kë kërkesë në mënyrë të strukturuar dhe të aksesueshme për qytetarët.

Mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit.
Zbatimi I programit të transparencës do të realizohet përmes :
-Përcaktimi I strukturave përgjegjse për çdo kategori informacioni;
-rolit të kordinatorit për të drejtën e informacionit;
-publikimit të informacionit në faqen zyrtare dhe në mjediset publike të bashkisë;Monitorimin periodik të përmbajtjes së detyrimeve ligjore;

-raportimit të rregullt mbi transparencën.

Vlerësimi I ligjshmërisë
Projekt vendimi mbështete në një bazë të plotë ligjorte.
Ligji nr.119/2014 përcakton detyrimin e autoriteteve publike për transparencë dhe publikim proaktiv të informacionit, ndërsa ligji nr. 139/2015 parashikon kopetencat e organeve vetëqeverisjes vendore për miratimin e akteve në fuksion të ushtrimit të veprimtarisë së tyre,Urdhri nr. 281, datë 30.12.2025 I Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për NJVV".

Përmbledhje shpeguese e projekt - aktit.
Projekt - vendimi "Për miratimin e programit të transparencës në Bashkinë Libohovë, hartohet në përputhje dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar si dhe nga urdhri nr.281, datë 30.12.2025 I Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
Qëllimi i këtij projekt vendimi është miratimi i Programit të Transparencës, si një instrumet i domosdoshëm për garantimin e të drejtës së publikut për informacion dhe për rritjen e transparencës në veprimtarinë e Bashkisë Libohovë.
Programi i transparencës përcakton kategoritë e informacionit që duhen të publikohen në mënyrë proaktive në faqen zyrtare të bashkisë mënyrën e publikimit të tyre si dhe përgjegjësinë e strukturave përkatëse për përditësimin dhe mirëmbajtien e këtij informacioni.
Ndërmjet këtij projekt-akti synohet:
-rritja e aksesit të qytetarve në informacionit publik;
-përmirësimi i komunikimit ndërmjet administratës dhe komuniteti;
-forcim i llogarridhënies dhe transparencës institucionale;
-përmbushja e detyrimeve ligjore në fushën e të drejtës së informacionit.

Miratimi i këtij programi është një detyrim ligjor për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Kordinatori për të drejtën e informimit
Daniela Hila

Nr. 6? Prot
Dt. 14.01.2026

1

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 72 prot. Tiranë, më 09.01.2026

Lënda: Mbi Programin model të Transparencës të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Raportimin periodik për zbatimin e kërkesave të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2025

**BASHKISË LIBOHOVË**

**Libohovë**

Të nderuar,

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "*Zyra e Komisionerit*") në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar (në vijim "*LDI*"), është autoriteti përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e transparencës proaktive të autoriteteve publike.

Programi i Transparencës (në vijim "*PT*") përbën një nga instrumentet themelore në funksion të transparencës proaktive, rritjes së llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike. Nëpërmjet tij, garantohet një akses sa më i gjerë dhe gjithëpërfshirës në informacionin dhe dokumentacionin me karakter publik për qytetarët dhe grupet e interesit.

Në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 6 të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miratoi Urdhrin nr. 281, datë 30.12.2025 "*Për miratimin e Programit model të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore*" (në vijim "*Urdhri 281/2025*"), publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 6, datë. 08/01/2026, i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (në vijim "NJVV").

Në shkronjën "c" të pikës 2 të nenit 4 të LDI përcaktohet se: "*Në përgatitjen e projektprogramit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos: c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji*". Gjithashtu, në nenin 5 të LDI përcaktohet se: "*Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas të njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi/i*

*tij. Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por, në asnjë rast, nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet".*

Gjatë vitit 2025, Zyra e Komisionerit është asistuar nga projekti "Mbështetje për Zyrën e Komisionerit", i "Bashki të Forta", Helvetas dhe zbatuar nga "Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim" të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar për sa i përket përmirësimit të transparencës proaktive të NJVV.

Në këtë kontekst, Zyra e Komisionerit ka vlerësuar propozimet për disa shtesa dhe ndryshime në Programin model të Transparencës të NJVV që nuk ndryshojnë thelbin e përmbajtjes së modelit ekzistues, por synojnë të konsolidojnë përvojën e mirë, veçanërisht në forcimin dhe përmirësimin e transparencës së tyre.

Ndryshimet konkretisht janë:

1. Në PT shtohet një fushë e re, Fusha 8 "Këshilli Bashkiak", dedikuar veprimtarisë së këtij organi të rëndësishëm. Në këtë fushë kërkohet të hidhet informacion lidhur me 8 nënfusha:
    - Informacion rreth këshilltarëve;
    - Informacion rreth komisioneve;
    - Kuadri rregullator i këshillit të NJVV;
    - Mbledhjet e Këshillit;
    - Konsultimet publike;
    - Vendimet e Këshillit të NjVV;
    - Kërkesat dhe përgjigjet drejtuar Këshillit të NJVV;
    - Veprimtaria e Këshillit, komunikimi me publikun dhe aspekte të tjera.
2. Fusha 1 "Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë" riformatohet në 6 nënfusha, pasi nënfushat 2 dhe 3, tashmë përfshihen në fushën 8.
3. Fusha 3 "Për kërkesa për informim" riformatohet në 4 nënfusha:
    - Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit;
    - Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankesës;
    - Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve;
    - Tarifa për dhënien e informacionin (nëse ka);

Në ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, përcaktohet, se këshillat e qarqeve përbëjnë nivelin e dytë të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe si të tilla, ato duhet të zbatojnë këtë model për Programin institucional të Transparencës.

Për sa më sipër, të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashki dhe këshilla qarqesh) kanë detyrimin të bëjnë rishikimin e Programit institucional të Transparencës, sipas modelit të miratuar me Urdhrin nr. 281/2025 jo më vonë se data 31 mars 2026.

Gjithashtu, në ushtrim të kompetencave ligjore, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miratoi Urdhrin nr. 1, datë 05.01.2026 "*Për miratimin e formatit të raportimit të autoriteteve publike mbi zbatimin e kërkesave te ligjit*

*për të drejtën e informimit për vitin 2025*". Ky akt vjen në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 24/1 të LDI. Plotësimi i këtij pyetësori me të dhëna të sakta dhe të përditësuara është një detyrim për çdo titullar apo person përgjegjës të autoriteteve publike, në mënyrë që të vihet në dispozicion i gjithë informacioni i domosdoshëm për Zyrën e Komisionerit në funksion të ushtrimit dhe përmbushjes së kompetencave ligjore. Periudha raportuese është janar-dhjetor 2025 dhe pyetësori i plotësuar, nënshkruar dhe protokolluar i dërgohet në rrugë zyrtare dhe/ose elektronike (info@idp.al) Zyrës së Komisionerit brenda datës 31 janar 2026.

Në lidhjen https://idp.al/nv25 do të gjeni dokumentet të shkarkueshme për plotësim/zbatim nga ana juaj, konkretisht :

- Urdhrin nr. 281, datë 30.12.2025 "*Për miratimin e Programit model të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore*";
- Urdhrin nr. 1, datë 05.01.2026 "*Për miratimin e formatit të raportimit të autoriteteve publike mbi zbatimin e kërkesave të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2025*".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

REPUBLIKA E SHQ...

**URDHËR**
**Nr. 281, datë 30.12.2025**

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT MODEL TË TRANSPARENCËS PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 6, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit Model të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, bashki dhe këshilla qarqesh.
3. Autoritetet publike të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, zbatojnë Programin institucional të Transparencës, sipas formës dhe përmbajtjes, në përputhje me lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri, jo më vonë se data 31 mars 2026.
4. Urdhri nr. 211, datë 10.9.2018, "Për miratimin e programit të transparencës të njësive të vetëqeverisjes vendore", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
**Besnik Dervishi**

**Lidhja nr. 1**

PROGRAMI I TRANSPARENCËS PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

**I. Tabela përmbledhëse e programit të transparencës**
[*Vendos emrin e njësisë së vetëqeverisjes vendore (NJVV)*]